

University of Business and Technology in Kosovo

UBT Knowledge Center

Theses and Dissertations

Student Work

Summer 7-2020

Përcaktimi i baktereve mezofile aerobe në qumështin e papërpunuar në regjionin e Lipjanit

Laureta Tasholli

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>



Part of the [Food Science Commons](#)



Kolegji UBT
Fakulteti i Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë

**PËRCAKTIMI I BAKTEREVE MEZOFILE AEROBE NË
QUMËSHTIN E PAPËRPUNUAR NË REGJIONIN E LIPJANIT**

Shkalla Bachelor

Laureta Tasholli

Korrik / 2020
Prishtinë



Kolegji UBT
Fakulteti i Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë

Punim Diplome

Viti akademik 2016-2017

Laureta Tasholli

**PËRCAKTIMI I BAKTEREVE MEZOFILE AEROBE NË
QUMËSHTIN E PAPËRPUNUAR NË REGJIONIN E LIPJANIT**

Mentori: Dr. sc. Hyzer Rizani

Korrik / 2020

Ky punim është përpiluar dhe dorëzuar në përmbushjen e kërkesave të
pjeshme për shkallën Bachelor

ABSTRAKT

Qumështi i nxjerrë nga një kafshë e shëndetshme tashmë përmban disa baktere. Shumica e ndryshimeve që ndodhin në aromën dhe pamjen e qumështit, pasi nxirren nga udderi, janë rezultatet e aktiviteteve të mikrobeve. Këto mikrobe janë të dy llojeve d.m.th. të favorshme - që sjell ndryshime të favorshme në aromë dhe pamjen ndërsa patogjene - të cilat mund të shkaktojnë sëmundje. Të mirat janë përhapur me kujdes ndërsa patogjenët (të pafavorshëm) shkatërrohen për të bërë qumështin dhe produktet e tij të sigurt për konsum njerëzor. Konsumi i qumështit gjatë dekadës së fundit është rritur në mënyrë të konsiderueshme në Kosovë. Në këtë hulumtim janë marrë 50 mostra qumështi, në disa vende pika grumbulluese dhe nga fermat e qumështit në dy fshatra dhe në rrethin të Lipjanit. Cilësia mikrobiologjike e mostrave të qumështit analizohet sipas standardeve zyrtare. Më pastaj, në qumështin e paperpunuar, është analizuar një numër i bakterieve aerofilike mezofile. Bakteret mezofile aerobike në qumështin e freskët, të përdorura si lëndë e pare, nuk treguan më shumë 2.07×10^6 cfu/ml.

Fjalët kyçe: qumësht, mezofil, aerobik, cfu.

MIRËNJOHJE/FALENDERIME

Punimi i diplomës është një punim që kërkon angazhim dhe vëmendje të veçantë ka një qëllim dhe strukturë të caktuar përmes të cilit përfundojnë studimet e nivelit Bachelor në Fakultetin e Shkencave të Ushqimit dhe Bioteknologjisë, në Kolegjin e UBT-së në Prishtinë.

Falënderoj stafin drejtues të UBT-së për mundësitë e ndihmës ofruara gjat periudhës së studimeve.

Falënderoj fermerët që mundësuan marrjen e mostrave dhe lejuan të vëzhgojmë procesin e prodhimit të produkteve të qumështit.

Falënderoj gjithashtu edhe laboratorin për ndihmën e ofruar, ku pa ndihmën e tyre realizimi i punimit do të ishte i vështirë.

Falënderoj Zotin për ndihmën, dhe familjen time për përkrahjen e vazhdueshme dhe besimin e ofruar gjatë viteve të studimit, besimi që ata kishin në mua me shtyu të vazhdoj tutje.

Për punimin e një teme diplome natyrisht se duhet kohë dhe përkushtim prandaj falënderoj dhe shpreh mirënjohje të pakushtë mentorit Dr.Sc Hyzer Rizani për ndihmën e ofruar për realizimin e kësaj teme të diplomes.

PËRMBAJTJA

LISTA E FIGURAVE.....	V
LISTA E TABELAVE	VI
FJALORI I TERMAVE	VII
1 HYRJE.....	1
2 SHQYRTIMI I LITERATURËS (HISTORIKU).....	2
2.1 Madhësia e baktereve.....	3
2.2 Ndërtimi i qelizës bakteriale	3
2.3 Përhapja e baktereve.	6
2.4 Kërkesat për oksigjen.....	6
2.5 Kërkesat ushqimore	7
2.6 Temperaturat e zhvillimit të baktereve	7
2.7 pH.....	8
2.8 Matja e masës së baktereve në kulturat e lëngëta	8
2.9 Studimi i parametrave mikrobiologjike të qumështit të pasterizuar.	9
2.10 Mikrobiologjia e qumështit lëndë e parë.....	10
2.10.1 Klasifikimi i përgjithshëm i mikroorganizmave të qumështit	10
2.10.2 Rritja e mikro-organizmave.....	14
2.10.3 Mikroflora e qumështit të papërpunuar	15
2.10.4 Bakteret Gram - pozitive	17
2.10.5 Mikroorganizmat patogjene.....	18
2.10.6 Mikroflora e qumështit të pasterizuar.....	19
2.10.7 Organizmat patogjene.....	22
3 DEKLARIMI I PROBLEMIT	25
3.1 Numërimi i mikroflorës karakteristike të qumështit të pasterizuar	25
3.1.1 Numërimi i mikroflorës totale mezofile bakteriale	25
3.1.2 Përcaktimi i majve dhe myqeve	26
3.1.3 Numërimi i mikroflorës termorezistente (Bacillus stearothermophilus dhe Bacillus cereus).....	26
4 METODOLGJIA.....	28
5 REZULTATET.....	30
6 DISKUTIME DHE PËRFUNDIME.....	33

7	REFERENCAT	34
8	APPENDICES	Error! Bookmark not defined.
8.1	CV e studentes	35

LISTA E FIGURAVE

Figure 1. Puna në laboratorin e mikrobiologjisë në UBT.....	29
---	----

LISTA E TABELAVE

Table 1. Standartet bakteriologjike të qumështit të freskët	11
Table 2. Numri i përgjithshëm i bakterieve mezofile në qumështin e freskët nga regjioni Shales.....	30
Table 3. Numri i përgjithshëm i bakterieve mezofile në qumështin e freskët nga regjioni Gadime	31
Table 4. Numri i përgjithshëm i bakterieve mezofile në qumështin e freskët nga rrethi i Lipjanit	32
Table 5. Mesatarja e numri i përgjithshëm i bakterieve mezofile në qumështin e freskët nëpër regjionet e hulumtimit.	32

FJALORI I TERMAVE

pH – paraqet jonet e hidrogjenit

DTA - (Dextrose Tryptone Agar)

E. coli - Escherichia coli

PCA - Plate Count Agar

VRBL - Crystal violet neutral red bile lactose

1 HYRJE

Qumështi është lëng biologjik që sekretohet në gjëndrën e individit femërorë, fitohet nga mjelja e plotë dhe e vazhdueshme e kafshëve të mirëmbajtura, me të cilin nëna ushqen të porsalindurin deri sa të zhvillohet

Për shkak të përbërjes së tij specifike qumështi i nënshtrohet zbërthimit të shpejtë bakteriologjik dhe enzimatik dhe për parandalimin e tyre janë përpiluar shume procedura teknologjike për përpunim. Në procedurat për pasterizim, sterilizim dhe zierje, qumështi i nënshtrohet temperaturave të larta gjatë të cilave shkatërrohen mikroorganizmat patogjene dhe enzimat, me çka rritet stabiliteti dhe afati i përdorimit të tij.

Qumështi është lëng me ngjyrë të bardhë, me shije të lehtë, të këndshme dhe me aromë karakteristike. Nga aspekti i industrisë së ushqimit mikroorganizmat mund të jenë të dobishëm dhe të dëmshëm. Mikroorganizmat të cilat hasen në qumështi dhe produktet e qumështit ndahen në:

1. mikroorganizma të dobishëm, përdoren gjatë prodhimit të produkteve të qumështit
2. mikroorganizma të dëmshëm, shkaktojnë mangësi të ndryshme dhe prishjen e qumështit dhe produkteve të qumështit
3. mikroorganizmat patogjen, nuk shkaktojnë ndryshime të padëshirueshme fizike-enzimatike në qumësht, por janë të rrezikshëm për shëndetin e konsumatorit.

Qumështi kontaminohet me mikroorganizma gjatë kohës së mjeljes, gjatë shtrydhjes së qumështit, manipulime tjera në ferma dhe gjatë transportit.

Sasia dhe lloji i mikroorganizmave varet nga pastërtia e kafshës që mjelet (në veçanti nga gjiri), enët dhe aparatet, ushqimi, stalla e kafshëve, uji, vendi për mjelje dhe nga higjiena e personit që mjel.

2 SHQYRTIMI I LITERATURËS (HISTORIKU)

Bakteret: janë mikroorganizma njëqelizorë zakonisht një mikrometër të gjatë, dhe kanë një gamë të gjerë të formave: koke, cilindrike, spiralet. Një qelizë bakteriale kryen të gjitha funksionet që e karakterizojnë jetën.

Bakteret jetojnë kudo në tokë, në ujë, në ajër, në organizmin e shtazëve dhe bimëve. Pra bakteret janë përcjellëse të litosferës, hidrosferës dhe atmosferës dhe numërohen përbërës thelbësor të biosferës.

Forma

Ndër bakteret janë të njohura këto forma themelore:

- Sferike (topthore)-koke
- Shkopthore ose cilindrike,
- Spirale (e lakuar),
- Penzore.

Format koke në hapësire mund të jenë të organizuara individualisht (mikrokoke), dy nga dy (diplokoke), në vargje të gjata ose të shkurtra (streptokoke), në formë tetradash (tetrakoke), si grumbuj në formë të kalaveshit të rrushit (stafilokoke).

Format e cilindrike. Në të vërtetë, janë forma shkopthore që lakohen (përdridhen) rreth boshtit të paramenduar. Format vibrio kanë një gjysmë të përdredhur, ato spirale –shumë të përdredhura të shtrira-të tërhequra dhe format spiroketa kanë shumë spiroлизime të ngjeshura. Format shkopthore janë cilindra që në mikroskop i shohim të vequara-monobacile të grupuara nga dy –diplobacile dhe në vargje –streptobacile.

Kështu duhet theksuar se format shkopthore nëse nuk kanë aftësi të krijimit të sporeve quhen asporagjene (forma shkopthore te tipit bacterium) dhe sporogjene që kanë aftësi të krijojnë spore (forma shkopthore të tipit bacillus).

2.1 Madhësia e baktereve

Matet me mikrometra dhe sillet prej:

0,0-1,5 (koket),

4-9 (bacilet) dhe

9-15 (format spirale).

2.2 Ndërtimi i qelizës bakteriale

Njësia më e vogël themelore jetësore, në mënyrë funksionale dhe strukturore, është një qelizë, dhe bakteret kanë organizimin më të thjeshtë të qelizave. Qeliza bakteriale është prokariotike. Të gjitha qelizat e tjera, përfshirë kërpudhat, algat, protozoarët, qelizat bimore dhe shtazore, janë eukariote.

Numri minimal i përbërësve strukturorë në një qelizë bakteriale është relativisht i vogël. Muri qelizor është i vetmi komponent strukturor i ngurtë. I jep qelizës formën e saj. Bakteret me mur qelizor të trashë janë pozitive Gram dhe bakteret me mur qelizor të hollë janë Gram-negative. Membrana qelizore përcakton se çfarë duhet të jetë brenda dhe jashtë qelizës. Vetëm substancat e tretshme në ujë mund të transferohen përmes membranës qelizore. Kështu që nuk ka shkëmbim midis qelizës dhe mjedisit apo rritjes së saj nëse uji nuk është i pranishëm.

Përmbajtja e brendshme e qelizës bakteriale shpërndahet në dy pjesë të njohshme: citoplazmën dhe kromozomin. Kromozomi është bartës i informacionit gjenetik në ADN-në e tij, acidi deoksi-ribonukleik. Në parim, një bakter përmban vetëm një kromozom d.m.th një molekulë të ADN-së. Informacioni i tij shndërrohet në enzima në citoplazmë.

Protoplastin e rrethon muri qelizor i zhvilluar. Te disa lloje bakteresh mbi murin ndodhen mbështjellësit e jashtëm: mikro dhe makrokapsolat dhe mbështjellësi jargor.

Membrana citoplazmatike ndër bakteret është e ngjashme me atë të qelizave shtazore. Ka natyrë lipoproteinike dhe roli i saj qëndron në këmbimin e materies në relacionin qelizë-mjedis dhe anasjelltas. Membrana ka aftësi të permeabiliteti selektiv. Të gjitha organelet me strukturë membranore të protoplastit (me përjashtim të materialit bërthamor) kanë origjinë nga membrana plazmatike.

Membrana bërthamore-nukeloidi. Për ndryshim nga bërthama e qelizave eukariotike kjo është në nivel më të ulët të organizmit. Bërthama bakteriale ka pozicion qendror (në mes) në trupin e bakterit. Ajo është e përbërë nga acidi deoksiribonukleik (ADN) në formë të kromozomi. Kromozomi (ADN) është i zhveshur dhe zakonisht ka forme unaze. Organizimi i bazës molekulare gjenetike në kromozomin bakterial është i ngjashëm me atë të organizmave tjerë aukariotë.

Roli themelor i nukleoidit është në ndarjen e qelizës dhe dirigjimin e proceseve jetësore: biosinteza, respiracioni, lëvizja, lumineshenca etj. Roli i mitokondrive është frymëmarrja-respiracioni. Në kondroidet janë të lokalizuara shumë enzime të cilat kryejnë proceset oksido reduktuese.

Retikulumi endoplazmatik ndër qelizat bakteriale është shumë i zhvilluar. Ai është sistem membranash që e përshkojnë tërë protoplastin. Në rrjetin endoplazmatik kryhet biosinteza e proteinave, karbohidrateve dhe yndyrnave.

Ribozomet janë organele me natyrë proteinike. Aty ka ARN ribozomale. Biosinteza e proteinave kryhet në ribosome.

Citoplazma është një përzierje homogjene e tretësirës koloide dhe asaj të vërtetë. Citoplazma mbush dhe plotëson qelizën bakteriale. Në të ka edhe proteina, karbohidrate, yndyra, vitamina, jone hidrogjeni, kaliumi dhe klori.

Citoplazma është gjysmë e lëngët, viskoze, e tejdukshme, me sasi të madhe uji (70 %). Në citoplazmë janë të zhytura nukleoidet, ribozomet dhe organelet e tjera intra qelizore.

Vakuolat paraqesin krijesa të rrethuara apo të mbuluara me membranë të posaqme-tonoplast.

Muri qelizor është formacion që e rrethon protoplastin. Ai jep formën konstante, fortësinë, elasticitetin dhe i ofron mbrojtje nga lëndimet fizike. Muri qelizor ndër bakteret ka strukturë kimike të ndërlikuar.

Te një grup bakteresh muri qelizor ka një strukturë me muropeptidin si bazë. Përbërja kimike e tij (muropeptidi) është e atillë që rrjeti i tij ka një shtrirje fizike dhe përbërje kimike specifike për veti. Dhe kur ngjyroset me metodën e gramit, qeliza merr ngjyre të kaltër. Këto baktere pra quhen grampozitive.

Në anën tjetër, një grup tjetër bakteresh ka muropeptidin me shtrirje fizike dhe përbërje kimike të ndryshme nga e mëparshmeja. Po të ngjyrosen këto me të njëjtën metodë të Gramit do të marrin ngjyrë të kuqe dhe quhen gram negative.

Ngjyrosja sipas Gramit mundëson të zbulojnë përbërje kimike të murit qelizor dhe njëkohësisht të dallojmë me lehtësi qelizën në mikroskop.

Flagjelët dhe fimbriet Flagjelët (kamxhikët, ciliet) janë vazhdimë të protoplazmës. Ato kanë pamjen e fijos cilindrike. Flagjeli ka strukturë proteinike shumë të hollë dhe me gjatësi shumë më të madhe se trupi i bakterit.

Sporet. Në kushte të vështirësuar të jetës inicohet krijimi i një trup në brendi të bakterit – sporës. Krijimi i spores (sporulimi) përfshin grumbullimin e materialit gjenetik, granulave, mënjanimin e ujit dhe krijimin e shtresave të brendshme të murit. Pra gjatë sporulimit qeliza vegetative shëndrrohet në sporë-farë. Spora nuk tregon aktivitet metabolik, por qëndron në gjendje latente me muaj e me vite. Kur spora gjendet në kushte të përshtatshme të jetës ajo mbin-pëlçet dhe shëndrrohet në qelizë vegetative-në formën e mëparshme. Pra krijimi i sporës është proces i tejkalimit të kushteve të vështirësuar të jetës.

Aftësia e krijimit të sporeve është veçori për disa gjini bakteresh të tipit bacillus : Clostridium, Bacillus.

2.3 Përhapja e baktereve.

Për shkak se kanë dimensione të vogla dhe se shumëzohen shumë shpejt, bakteret kanë arritur të kolonizojnë hapësirat dhe gjenden gjithkund në natyrë. Ato i gjejmë në pole, në zonat tropike, kontinentale, në gejzerë, ujëra të ftohta, në të gjitha kategoritë e ujërave, në sipërfaqe dhe brendi të shtazëve, bimëve, në sipërfaqe të tokës dhe në thellësi të deteve, në shkretëtira dhe puse të naftës, në rezerva të thëngjillit dhe në xehe. Pra kudo. Për këtë shkak ata quhen organizma ubikuiste.

Për t'u rritur, bakteret duhet të sigurojnë burime të energjisë, si p.sh. karbonin "organik" – që marrin nga sheqernat dhe acidet e ngopura si dhe jonet e metaleve (p.sh. hekuri). Rol të rëndësishëm për rritjen e baktereve kanë edhe temperatura optimale, pH dhe kërkesat për oksigjen.

2.4 Kërkesat për oksigjen

Shumë mikroorganizma kanë nevojë për oksigjen të lirë për të oksiduar ushqimin e tyre në mënyrë që të prodhojnë energji dhe të mbështesin proceset e tyre të jetës. Oksidimi i plotë i përbërjeve organike formon CO₂ dhe ujë. Shumë mikroorganizma mund të përdorin ajrin në presionin atmosferik, dhe këta quhen mikroorganizma aerobikë. Llojet e tjera marrin energji nga ushqimi i tyre pa nevojë për oksigjen të lirë, dhe këto quhen mikroorganizma anaerobe.

Ka disa baktere që konsumojnë oksigjen të lirë nëse është e pranishme, por që mund të rriten në mungesë të oksigjenit të lirë. Bakteret e tilla quhen fakultative anaerobe. Bakteret anaerobe dhe anaerobe fakultative në përgjithësi marrin energjinë e tyre me anë të fermentimit të komponimeve organike. Ndërsa shumica e organizmave marrin oksigjenin e tyre nga ajri, d.m.th. ata janë aerobikë, heqja e oksigjenit / ajrit është një mjet për të kontrolluar ose parandaluar rritjen e tyre. Bakteret anaerobe vdesin nëse i ekspozohen oksigjenit atmosferik për çdo gjatësi kohe.

2.5 Kërkesat ushqimore

Tek kërkesa ushqimore bëjnë pjesë burimet e karbonit, azotit, fosorit, sulfurit dhe jonet metalike si p.sh. hekuri. Bakteret sekretojnë disa molekula të vogla, të cilat e lidhin hekurin (sidoforet, p.sh. enterobaktina, mikobaktina). Pastaj, sideroforet, me hekur të lidhur futen Brenda përmes receptorëve të qelizës bakterore. Njeriu, po ashtu posedon proteinat transportuese të hekurit (transferinat). Bakteret që nuk garojnë me strehuesin për burime të hekurit, janë patogjenë të dobët.

2.6 Temperaturat e zhvillimit të baktereve

Temperatura është faktori më i madh i vetëm që ndikon në rritjen, shumëzimin dhe përkeqësimin e ushqimit. Bakteret mund të zhvillohen vetëm brenda kufijve të caktuar të temperaturës, të cilat ndryshojnë nga një specie në tjetrën.

Bakteret mund të ndahen në kategoritë e mëposhtme sipas diapazonit të tyre të preferuar të temperaturës:

Bakteret psikrofile (të ftohta) dhe rriten mirë në 0°C me një temperaturë optimale rreth $12 - 15^{\circ}\text{C}$ dhe maksimumin nën 20°C .

Bakteret psikrotrofike (të ftohta-tolerante) janë llojet mesofilike që mund të shumohen në temperaturat komerciale të ftohjes me një temperaturë optimale rreth $20 - 30^{\circ}\text{C}$.

Bakteret mesofile kanë një temperaturë minimale rreth 10°C , dhe në përgjithësi një optimale prej $30 - 35^{\circ}\text{C}$ dhe maksimum në rreth 50°C . Pa dyshim, ky është rrezja më e zakonshme për rritjen e baktereve. Përafërsisht 90% e të gjitha baktereve mund të rriten në këtë interval të temperaturës.

Bakteret termofilike (që e duan nxehtësinë) kanë temperaturat e tyre optimale të rritjes në $55 - 65^{\circ}\text{C}$. Temperatura minimale rreth 37°C dhe maksimumi rreth 70°C .

Bakteret psikrotrofike janë me interes të veçantë për industrinë e qumështit, sepse aktiviteti mikrobiologjik në qumështin e fermës dhe qumështin e tregut zakonisht zhvillohet në një temperaturë prej 7 ° C ose më poshtë.

2.7 pH

Shumica e mjediseve natyrore kanë vlera të pH midis 5 dhe 9, dhe mikroorganizmat më të zakonshëm optimizohen për rritje në këtë rang. Shumica e mykëve dhe majave rriten më së miri në medis pak acid, rreth pH 5 deri në 6, ndërsa kushtet optimale për bakteret janë ambiente neutrale ose pak alkaline.

Qumështi i freskët normalisht ka një pH midis 6.6 dhe 6.8. Myqet dhe maja në përgjithësi rriten mirë në pH aq të ulët sa 3, ose edhe pH 2. Shumica e ushqimeve jo të përpunuara kanë një pH pak më poshtë se neutral, d.m.th. ato janë ushqime me acid të ulët.

2.8 Matja e masës së baktereve në kulturat e lëngëta

Metodat më të shpeshta për matjet e tilla janë matja e:

a) Turbiditetit (shkalla e turbullimit të kulturës së lëngët nga ana e baktereve – vlerë e cila mat numrin e përgjithshëm të baktereve (të gjalla dhe të vdekura). Kjo metodë zakonisht realizohet me spektrofotometër.

b) Numri i baktereve të gjalla në kulturë – zakonisht përcaktohet përmes numrit të kolonive që rriten pas kultivimit të një vëllimi të ditur në pllakë (“numërimi në pllakë” i njësive koloni formuese - colony forming units).

Rritja e baktereve mund të paraqitet me lakoren e rritjes (figura 1) ku jepet numri i qelizave të gjalla në raport me kohën. Koha e gjenerimit është koha e nevojshme për dyfishimin e popullacionit bakteror.

<https://sq.wikipedia.org/ëiki/Bacteria>

2.9 Studimi i parametrave mikrobiologjike të qumështit të pasterizuar.

Qumështi, materiet ushqyese dhe parametrat kimike-fizike të tij, janë mjaft të përshtatshme për zhvillimin e mikroorganizmave të të gjitha llojeve, nga të cilat, në të shumtën e rasteve janë forma patogjene dhe shkaktojnë sëmundje e madje në disa raste mjaft të rrezikshme për shëndetin e konsumatorit siç janë: Tuberkuloza, Bruceloza, Diarretë etj. Sa më i madh të jetë numri i mikroorganizmave në qumësht aq më e madhe është gjasa që në të, të ketë forma patogjene.

Nga qumështi i papërpunuar mund të izolohen shumë patogjenë. Rritja e këtyre patogjenëve në qumësht pengohet nga ftohja dhe konkurrenca e mikroorganizmave jo-patogjene, shpërthimet e sëmundjeve të shkaktuar nga *Campylobacter jejuni*, *Escherichia coli*, *Staphylococcus aureus*, *Listeria monocytogenes*, *Salmonella spp.* dhe *Yersinia enterocolitica* janë raportuar pas konsumimit të qumështit të papërpunuar

Prishja e qumështit të pasterizuar shkaktohet nga: rritja e baktereve sporo formuese, të mbijetuar (*Bacillus spp.* dhe *Clostridium spp.*), rritja e baktereve termorezistente (p.sh. *Micrococcus*, *Streptococcus spp.*, *Enterococcus spp.*, *Lactobacillus spp.* dhe ndonjëherë gram negative në formë shufre) (Hileman et al, 1941; Chadwick Hayes, 2001) dhe rikontaminimi dhe rritja e baktereve psikrotrofe (gram negative) (p.sh. *Pseudomonas spp.*). Aktiviteti i enzimave termorezistente prodhuar para pasterizimit. Krahasuar me trendin e higjienës në fermë, trajtimi i përmisuar i qumështit në proceset e përpunimit të qumështit (p.sh. magazinimi i zgjatur frigoriferik, temperaturat më të larta të trajtimit të ngrohjes, kontrolli i rikontaminimit pas trajtimit të ngrohjes) rritin rëndësinë e sporoformuesve termorezistentë, në lidhje me jetëgjatësinë e produktit.

Aktualisht, industria e qumështit synon nivelet maksimale të sporeve, 10³ spore l-1 të qumështit të papërpunuar, për të siguruar cilësinë dhe sigurinë e qumështit të pasterizuar dhe produktet e qumështit.

2.10 Mikrobiologjia e qumështit lëndë e parë

Qumështi është një produkt që merret nga një ose disa mjelje të gjitarëve që mbahen dhe rriten për qëllim prodhim qumështi.

Teorikisht qumështi i mjelë nga kafshë të shëndosha dhe i mbledhur në kushte aseptike, duhet jetë i pastër e të përmbajë vetëm mikroorganizma me origjinë endohigjenike. Kushtet reale në praktikë janë të ndryshme, kështu që ndotja e qumështit varet nga shumë faktorë të jashtëm e të brendshëm. Këto ulin vlerat e tij, humbasin natyralitetin, ulin vlerën ushqimore duke kthyer ndonjëherë edhe në burime të dëmshme, japin gjithashtu dhe vështirësi në teknologji. Mikroorganizmat pranishme në qumësht mund të klasifikohen në dy grupe kryesore: patogjene dhe organizmat përgjegjëse të prishjes, edhe pse disa mund të luajnë një rol të dyfishtë (p.sh. *Bacillus cereus*). Organizmat patogjene përbëjnë një kërcënim për publikun shëndetësor. Në sajë të enzimave të tyre termorezistente (p.sh. proteaza, peptidaza, lipaza, esteraza, oksidaza, polimeraza, β -galaktozidaza), organizmat përgjegjëse të prishjes janë të afta të hidrolizojnë përbërësit e qumështit të tilla si proteina, yndyra dhe laktoza, në mënyrë të përshtatshme për të përfutur përbërësit e nevojshëm për rritjen e tyre. Reaksionet e tilla mund të çojnë në prishje të qumështit, që shoqërohet me ndryshim të aromës, shijes dhe ndryshimet në cilësi dhe pamjen e qumështit (Frank&Hassan,2003).

2.10.1 Klasifikimi i përgjithshëm i mikroorganizmave të qumështit

Bakteret: - janë mikroskopike, njëqelizor, ndodh në formën e qelizave sferike, cilindrike ose spirale. Bakteret sporformuese krijojnë probleme në industrinë e qumështit për shkak të rezistencës së tyre ndaj pasterizimit. Sa më i madh të jetë numri i tyre aq më e ulët është cilësia mikrobiologjike e qumështit. Standardet e mëposhtme bakteriologjike të qumështit

të papërpunuar janë sygjëruar si një udhëzues për kategorizimin e qumështit të papërpunuar në Indi.

Table 1. Standartet bakteriologjike të qumështit të freskët

cfu/ml	Vlerësimi
Jo më tepër se 2,00,000	Shumë i mire
Midis 2,00,000 dhe 10,00,000	I mire
Midis 10,00,000 dhe 50,00,000	I pranueshëm
Mbi 50,00,000	Jo i pranueshëm

**Qumështi i pasterizuar duhet të ketë një ngarkesë që nuk kalon vlerën 30,000 e cfu/ml.*

Bakteret në qumësht klasifikohen në dy tipe kjo në varësi të disa vetive: Gram pozitive dhe në Gram negative. Sipas sjelljes ndaj Gramit qelizat bakteriale grupohen si Gram negative dhe Gram pozitive.

Bakteret kryesore në qumësht: shumica janë vizitorë të rastit të cilat mund të gjallojnë dhe të riprodhohen por shpesh mjedisi është i papërshtatshëm për zhvillimin e tyre. Disa vdesin gjatë konkurrimit me lloje të cilët ky mjedis është i pëlqyeshëm. Grupet e baktereve që gjenden në qumësht klasifikohen specifikisht më poshtë: 23 Gram negative psikotrofe, është grupi më i rëndësishëm nga ana sasiore, sidomos në qumështin që ka pasur një ftohje paraprakisht. Mbizotëron gjinia *Pseudomonas* me specie *fluorescens*, *fragi*, *putrificiens* etj. Këto forma shpjegojnë edhe veprimin proteolitik e lipolitik dhe prodhojnë proteaza termorezistente. Kanë tendencë të alkalizojnë qumështin ose së paku të mos e acidifikojnë atë. Gram negative, anaerob fakultativë- përfshijnë forma që i përkasin familjes *Enterobacteriaceae* dhe veçanërisht Coliforme e *Aeromonas*. Mund të jenë si rezultat i higjenes jo të mirë. Numri i tyre ndryshon dukshëm dhe zakonisht ato gjenden në praktikë kur normat e prodhimit higjenik janë jo të rregullta. Vlerat e koliformëve në qumësht janë të larta dhe ato variojnë nga 10⁴ e 10⁵ dhe në qumështin e ndotur 10⁶. Baktere psikotrofe janë baktere të cilët janë të aftë të rriten në temperatura frigoriferike, ≤5 oC. Baktere mezofilë- baktere të cilët janë të aftë të rriten në temperatura 28-30oC, si *Streptococcus diactylactis*, *Leuconostoc cremoris*, *Lactococcus*. Baktere termofilike- baktere të cilat janë

të afta të rriten në temperatura 50°C, ose mbi. Mund të përmëdim Bacillus, Streptococcus (Streptococcus thermophilus), Lactobacillus (Lactobacillus helveticus) etj. Baktere termoduruese janë baktere të cilat janë të afta t'i mbijetojnë pasterizimit. Disa specie të Micrococcus, Lactobacillus, Bacillus, Clostridium (sporet) përfshihen në këtë grup. Baktere sporoformuese janë të afta të prodhojnë spore. Në këtë grup përfshihen specie të Bacillus, Clostridium etj. Ato klasifikohen sporoformuese aerobe, sporoformues anaerobe, sporoformuese hidhëruese, sporoformuese termofilike dhe sporoformuese sulfide. Baktere aerobe janë baktere që kërkojnë oksigjen për rritjen dhe shumimin e tyre. Këtu përmëdim Pseudomonas, Bacillus etj. Baktere anaerobe baktere të cilat nuk mund të rriten në prani të oksigjenit, përmëdim specie të Clostridium Anaerob fakultativ janë të afta të rriten në prani dhe në mungesë të oksigjenit, përmëdim Lactobacillus, Leuconoctoc, enteric patogjen dhe disa specie të Bacillus, Serretia dhe koliformët. Baktere koliforme janë anaerob fakultativë më një temperaturë optimale prej 30-37°C. Gjenden në zorrë në plehun organik, në ujin e ndotur e në bimë. Fermentojnë laktozën në acid laktik e në acide të tjerë organikë, në dioksid karboni e hidrogjen dhe shpërbëjnë proteinat duke dhënë shije e erë të padëshirueshme, disa prej tyre shkaktajnë dhe mastit. Shkaktojnë probleme të mëdha në bërjen djathit. Ato vdesin nga pasterizimi TLKSH. Përdoren si organizma provë për kontrollin e zakonshëm bakteriologjik të cilësisë në baxho a fabrikë. Nëse gjenden në qumësht apo tubacione pas pasterizimit kjo është shenjë rikontaminimi që dëshmon se punët e përditshme të pastrimit e dizefektimit duhen përmisuar. Baktere laktike gjenden në bimë në natyrë, në vende ku ka qumësht, në zorrët e kafshëve. Hyjnë bacille dhe koke që mund të formojnë vargje, janë anaerobe fakultativë, shumica vdesin në nxhetësi deri në 70°C edhe pse temperatura vdekjeprurëse për disa është 80°C, parapëlqejnë laktozën si burim karboni dhe e 24 fermentojnë atë në acid laktik. Nuk përfaqësojnë florën dominuese në qumësht. Numri i tyre është i ndryshueshëm dhe më të zakonshmit janë Sterptococcus e grupit N, Enterococcus dhe Streptococce-et e grupit D. Përmbajtja e tyre varion 0,2-3-4%. E njëjta gjë thuhet e për Sterpotcoccon Thermophylus që në shumicën e rasteve mungojnë. Baktere fekale këtu përmendet kryesisht E. coli dhe është tregues i higjenës. Baktere kalbëzuese prodhojnë enzima proteinë ndarëse, pra ato mund të shpërbëjnë proteinat deri në fund në amonjak. Ky tip shpërbërje quhet kalbëzim.

Këtu përfshihen larmi llojesh koke e bacile aerobe e anaerobe, Hynë në qumësht nga plehu organik, ushqimi i thatë për bagëti dhe uji. Shpërbëjnë dhe yndyrën si rrjedhojë e prodhimit të enzimës lipazë. Baktere proteolitike, baktere që mund të hidrolizojnë proteinat sepse ato prodhojnë proteinaza jashtëqelizore. Këtu përmëndim specie të gjinisë Mircoccus, Bacillus, Staphylococcus, Pseudomonas etj. Baktere lipolitike, baktere që janë të afta të hidrolizojnë trigliceride sepse ato prodhojnë lipaza jashtëqelizore. Të tilla mund të përmëndim: Mircoccus, Staphylococcus, Pseudomonas, Bacillus, Flavobacterium etj. Baktere që prodhojnë gaz (CO₂, H₂S, H₂) si rezultat i shfrytëzimit të elementëve ushqyes. Specie të tilla janë ato të gjinisë Leuconostoc, Lactobacillus, Enterobacter, Clostridium etj. Baktere sacharolitike janë të afta të hidrolizojnë karbohidratet komplekse. Mund të përmendim si: Bacillus, Clostridium etj. Sot në produktet e qumështit përdoren L.acidophilus dhe Bifidobacteria që i mbijetojnë kalimit të stomakut të njeriut e kur pH është 2, formojnë koloni në muret e zorrëve duke ulur zhvillimin e E.coli dhe baktereve padëshirueshme dhe në parandalimin e diaresë.

Myqe - . Shumëqelizor me shumë karakteristika dalluese gjithmonë gjenden në tokë, por mund të gjenden edhe në ujë dhe ajër.

Përgjegjës për dekompozimin e shumë materialeve, janë të dobishme për prodhimin industrial të shumë kimikateve, përfshirë penicilinën.

Mund të shkaktojë sëmundje te njerëzit, kafshët dhe bimët, organizmat e prishjes së ushqimit, veçanërisht të ushqimeve me acid të lartë.

Maja - Njëqelizore, ovale ose në formë të rrumbullakët.

Shpesh gjendet në shumë ambiente: tokë, bimë dhe fruta

Përdoret si shtesë ushqimore dhe në prodhimin e pijeve alkoolike

Organizmat e prishjes së ushqimit, veçanërisht të ushqimeve me acid të lartë

2.10.2 Rritja e mikro-organizmave

Bakteret shumëzohen gjatë prodhimit dhe mbajtjes së qumështit, në varësi të kohës dhe kushtet e magazinimit. Ndryshimet që ndodhin në vetitë fiziko-kimike të qumështit janë rezultat i aktiviteteve të qelizave mikrobike individuale gjatë periudhës së rritjes dhe riprodhimit ose e substancave të prodhuara gjatë aktivitetit të tillë.

Produktet e rritjes së mikroorganizmave:

- i. Enzimat
- ii. Produktet e zbërthimit (yndyrna, proteina, sheqerna).
- iii. Pigmented
- iv. Toksinat
- v. Ndryshime të ndryshme.

Ndryshimet në qumësht si rezultat i aktivitetit mikrobial :

- i. prishja: - haset me shpesh, për shkak të transformimit të laktozës në acidit laktik dhe acidet e tjera të paqëndrueshme dhe komponimet, kryesisht nga bakteret e acidit laktik.
- ii. prishje dhe çlirim gazi: shkaktohet nga grup bakteresh në formë spirale, e cila tregon kontaminimin e qumështit dhe produkteve të tij.
- iii. prodhimi i aromave të ndryshme: këto për shkak të prodhimit të disa komponentëve të padëshirueshme të diacetil.
- iv. proteoliza: është zbërthimi i proteinave që çon në erë të pakëndshme.
- v. lipoliza- e cila është zbërthimi i yndyrës në glicerol dhe acide yndyrore të lira të cilat shkaktojnë shije dhe aromë të pakëndshme.

2.10.3 Mikroflora e qumështit të papërpunuar

Mikoorganizmat që gjenden në qumështin e papërpunuar varen nga temperatura, koha e magazinimit, si dhe metodat e trajtimit gjatë dhe pas mjeljes (Varnam & Sutherland, 2001).

2.10.3.1 Mikroorganizmat përgjegjëse të prishjes

2.10.3.2 Bakteret psikrotrofe, Gram-negative

Gjatë ruajtjes së ftohtë pas grumbullimit të qumështit, popullsitë bakteriale psikrotrofike mbizotërojnë në mikroflora, dhe enzimat e tyre jashtëqelizore, kryesisht proteazat dhe lipazat, kontribuojnë në prishjen e produkteve të qumështit. Prandaj, përbërja e florës bakteriale psikrotrofike në qumështin e papërpunuar ka një rol të rëndësishëm në përcaktimin të cilësisë së qumështit. Monitorimi i specieve dominuese psikrotrofike përgjegjëse për prodhimin e enzimave proteolitike dhe lipolitike të qëndrueshme ndaj nxehtësisë ofron një mjet të ndjeshëm dhe efikas për ruajtjen e një cilësie më të mirë të qumështit në industrinë e qumështit.

2.10.3.3 Pseudomonas spp.

Prishja e qumështit shkaktohet nga prania e enzimave proteolitike të prodhuara nga *Pseudomonas* spp. gjatë ruajtjes në temperatura të ulëta. Qëllimi i këtij studimi ishte identifikimi i *Pseudomonas* spp. në qumësht të papërpunuar dhe të hetojë vetitë e tyre proteolitike të lidhura në temperatura të ulëta. Prishja e qumështit që vjen nga ndotja e produkteve të qumështit me mikroorganizma psikrotrofikë sjell humbje të konsiderueshme për industrinë ushqimore dhe është një shqetësim i veçantë i industrisë së qumështit (Dogan dhe Boor, 2003). Qumështi zakonisht ruhet në temperatura të ulëta për 2 deri 5 ditë përpara trajtimit të nxehtësisë (De Jonghe et al., 2011; Baur et al., 2015). Gjatë ruajtjes, mikrobiota zhvendoset drejt mikroorganizmave psikrotrofikë, të cilat mund të ulin cilësinë e qumështit të papërpunuar (Lafarge et al., 2004; Xin et al., 2017).

Llojet *Pseudomonas* të zbuluara më shpesh në qumësht dhe produktet e qumështit janë *P. fluorescens*, *P. gessardii*, *P. fragi*, dhe *P. lundensis* (Mallet et al., 2012). *Pseudomonas* spp. mund të rritet me një interval temperaturë prej 4–42 ° C, me një temperaturë optimale të rritjes mbi 20 ° C (Chakravarty dhe Gregory, 2015). Rritja e *Pseudomonas* shpesh shoqërohet me prodhimin e enzimave jashtëqelizore (p.sh., peptidazat dhe lipazat).

